

E DREJTA PËR INFORMIM

Raporti mbi vetëdeklarimin e autoriteteve publike



“Raporti mbi vetëdeklarimin e autoriteteve publike për zbatimin e kërkesave të ligjit për të drejtën e informimit për vitin 2025” është një dokument në funksion të forcimit akoma edhe më shumë të veprimtarisë mbikëqyrëse dhe monitoruese të mekanizmave e procedurave për njohjen e qytetarëve apo grupeve të interesit me informacionin/dokumentacionin me karakter publik.

Për përmbushjen e këtij detyrimi ligjor, gjatë muajit janar 2026 u dërgua pranë çdo autoriteti publik formulari i raportimit mbi zbatimin e kërkesave të LDI për vitin 2025.

Formulari i raportimit, ashtu si edhe një vit më parë, përmban 16 (gjashtëmbëdhjetë) pyetje, disa prej të cilave edhe me nënpyetje, për të identifikuar/saktësuar si të dhënat e përgjithshme të AP, si emërtesa, faqja zyrtare në internet, pasja e Programit të Transparencës, të koordinatorit dhe të dhënave të tij/saj të kontaktit, ashtu edhe ato me një natyrë më specifike, që kanë të bëjnë me prirjet e kërkimit të informacionit/dokumentacionit me karakter publik, identifikimin e kërkuesve, rastet e kufizimit apo përfaqësimi në proceset gjyqësore, etj.

Në të dhënat e kërkuara për t’u raportuar për vitin 2025 është edhe ajo në lidhje me kthimin e përgjigjeve brendave 3 ditëve pune, çka përbën 36% (tridhjetë e gjashtë) të totalit. Nëpërmjet identifikimit të kësaj të dhëne, konstatohet një prirje e AP për të qënë më efektive në procesin e kthimit të përgjigjeve, çka vlerësohet nga Zyra e Komisionerit pozitivisht dhe përbën një praktikë të mirë që duhet nxitur për t’u përkrahur në të ardhmen nga më shumë autoritete publike. Vlen të nënvizohet fakti, se standardet e larta të transparencës në tërësi janë rezultat si i përgjegjshmërisë profesionale të nëpunësve/punonjësve, ashtu dhe i qëndrueshmërisë e funksionalitetit të strukturës institucionale.

| Veprimtaria mbi zbatimin e LDI | Viti 2025 | Viti 2024 |
|---|-----------|-----------|
| Nr. total i AP ku u dërgua formulari i raportimit | 368 | 355 |
| Nr. i AP që kanë raportuar | 355 | 351 |
| Nr. i kërkesave për informacion publik, regjistruar në Regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve | 13029 | 11549 |
| Kërkesa që kanë marrë përgjigje të plotë | 11017 | 9289 |
| Kërkesa që kanë marrë përgjigje të pjesshme/të kufizuar | 390 | 688 |
| Kërkesa të refuzuara | 248 | 191 |
| Kërkesa të deleguara te një autoritet tjetër | 669 | 611 |
| Kërkesa nga gazetarë ⁷ | 2979 | 3129 |
| Kërkesa nga përfaqësues të shoqërisë civile ⁸ | 1051 | 1540 |
| Kërkesa që kanë marrë përgjigje brenda 3 ditëve pune ⁹ | 4666 | - |

Forcohet transparenca në nivel vendor përmes Programit Model të Transparencës dhe nxitjes së të dhënave të hapura

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale zhvilloi në Tiranë një aktivitet trajnues me përfaqësues të njësive të vetëqeverisjes vendore, në kuadër të forcimit të transparencës dhe llogaridhënies në nivel lokal. Aktiviteti u realizua në bashkëpunim me programin “Bashki të Forta” (Helvetas) dhe Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM).



Në fjalën e tij, Komisioneri Besnik Dervishi vlerësoi bashkëpunimin me partnerët për mbështetjen në hartimin e Programit të ri Model të Transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe për organizimin e aktiviteteve ndërgjegjësuese në nivel rajonal. Ai theksoi se me urdhrin nr. 281/2025 është miratuar modeli i ri i Programit të Transparencës, ku një nga risitë kryesore është përfshirja e një fushe të dedikuar për Këshillat Bashkiakë.

Komisioneri nënvizoi se Këshillat Bashkiakë janë ndër organet më të rëndësishme vendimmarrëse në nivel vendor dhe transparenca e tyre është thelbësore për garantimin e llogaridhënies ndaj qytetarëve. Ai rikujtoi se tashmë ka nisur faza e zbatimit konkret të Programit të Transparencës nga ana e bashkive, duke theksuar nevojën për publikim të saktë, të plotë dhe të përditësuar të informacionit në faqet zyrtare. Në këtë proces, u evidentua roli kyç i sekretarëve të këshillave bashkiakë, si dhe rëndësia e bashkëpunimit me strukturat e teknologjisë së informacionit për të garantuar publikim funksional dhe të aksesueshëm për publikun.



Një vëmendje e veçantë iu kushtua edhe zbatimit të ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, i cili përbën një hap të rëndësishëm drejt rritjes së transparencës, aksesit dhe ripërdorimit të informacionit publik. U theksua se njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë një rol të veçantë në këtë drejtim, duke qenë niveli më i afërt me qytetarin dhe administrues të të dhënave me ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e përditshme.

Bashkëpunim rajonal dhe inovacion në të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale organizoi një takim tre-ditor pune, përkatësisht në datat 28-30 prill 2026, me pjesëmarrjen e delegacioneve të Agjencisë për Informim dhe Privatësi të Kosovës dhe Agjencisë Kroate për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në përputhje me agjendën, dita e parë e takimit nisi me vizitën zyrtare të delegacionit të Agjencisë Kroate për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (AZOP) në ambientet e Zyrës së Komisionerit. Gjatë këtij takimi u zhvilluan diskutime mbi qasjet institucionale, prioritetet dhe përvojat përkatëse në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, duke krijuar bazën për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve dhe përgatitjen e një angazhimi të përbashkët në kuadër të thirrjes së Komisionit Evropian “CERV-2026-DATA”.



Dita e dytë vijoi me takimin trepalësh me pjesëmarrjen edhe të Agjencisë për Informim dhe Privatësi të Kosovës, ku diskutimet u përqendruan në konkretizimin e bashkëpunimit dhe avancimin e përgatitjes së një projekti të përbashkët. Në këtë kuadër, pala kroate e përfaqësuar nga znj. Anamarija Mladinic prezantoi platformën “Olivia”, një mjet inovativ për mbështetjen e funksioneve të autoriteteve të mbrojtjes së të dhënave dhe ndërveprimin me publikun.

Ndërsa dita e tretë e këtij takimi u fokusua në shkëmbimin e praktikave më të mira ndërmjet dy autoriteteve të Shqipërisë dhe Kosovës. Nga Zyra e Komisionerit u prezantuan disa prej instrumenteve dhe praktikave kryesore në të dyja fushat e përgjegjësisë Në fushën e së drejtës për informim, Drejtoresha e Monitorimit të Programeve të Transparencës, znj. Emerlinda Pema, prezantoi “Raportin e Vetëdeklarimit të Autoriteteve Publike mbi Zbatimin e Ligjit për të Drejtën e Informimit”, ndërsa inspektorët e zyrës sollën raste konkrete mbi shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankesave.



Zhvillohet takimi i dytë për vitin 2026 i Komitetit Ekzekutiv të ICIC


Më datën 16 prill 2026, u zhvillua online takimi i dytë i Komitetit Ekzekutiv të ICIC për këtë vit. Mbledhja u hap nga Drejtori i Kabinetit i Zyrës së Komisionerit, znj. Besa Velaj, e cila prezantoi rendin e ditës, përshëndeti anëtarët dhe vlerësoi punën e organizatorëve të konferencës në Sierra Leone, si edhe të Komitetit të Planifikimit.

Në vijim, Komisioneri Shaw, i autoritetit të Sierra Leone në cilësinë e organizatorit të konferencës ICIC 2026, prezantoi ecurinë e përgatitjeve. Ai ndau në kohë reale draft-agjendën e sesionit të hapur, e cila përfshin ceremoninë e hapjes, sesione plenare dhe paralele. Në panelin e hapjes parashikohet pjesëmarrja e përfaqësuesve nga UNESCO, OKB, Komisioneri shqiptar në cilësinë e Presidentit të ICIC dhe Presidenti i Sierra Leone.

Gjatë diskutimeve, u propozua që koalicioni i organizatave të shoqërisë civile të ketë një prezantim të shkurtër (5-10 minuta) gjatë sesionit të mbyllur të anëtarëve të ICIC. Ky propozim u mbështet nga anëtarët e Komitetit Ekzekutiv, ndërsa detaje të mëtejshme pritet të paraqiten në mbledhjet në vijim.

Komiteti miratoi edhe nisjen e procesit të zgjedhjes së anëtarëve të rinj të Komitetit Ekzekutiv, dhe përzgjedhjen e organizatorit të ICIC 2028. Zyra e Komisionerit në cilësinë e Sekretariatit përgatiti materialet dhe do të zbatojë sipas afateve hapjen e këtyre thirrjeve.

Diskutime të tjera u realizuan mbi dokumentin e Parimeve të Berlinit dhe çështje të tjera mbi aktivitetet që lidhen me ICIC.



Na ndiqni edhe në rrjetet sociale:



Zyra e Komisionerit në Simpoziumin e ASEAN-it mbi transparencën dhe bashkëpunimin

Zyra e Komisionerit mori pjesë në simpoziumin e organizuar virtualisht në kuadër të ASEAN-it (rrjeti rajonal i shteteve të Azisë Juglindore), ku u prezantuan praktikat dhe zhvillimet në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Në këtë forum ndërkombëtar u theksua roli i Zyrës së Komisionerit si Presidencë dhe Sekretariat i ICIC, ndërsa u prezantuan dhe u promovuan aktivitetet dhe iniciativat e rrjetit në shkëmbimin e përvojave dhe krijimin e standardeve globale për aksesin në informacion dhe transparencën. Në këtë kuadër, znj. Emerlinda Pema, Drejtore e Monitorimit të Programeve të Transparencës, prezantoi qasjen institucionale dhe zhvillimet kryesore në këtë drejtim, kryesisht duke u fokusuar në aktivitetin e rrjetit ICIC.

Gjatë prezantimit, znj. Pema theksoi dhe vuri në pah arritjet dhe zhvillimet më të fundit të rrjetit, si dhe ndau me pjesëmarrësit sfidat dhe objektivat e ardhshme.

Paneli përfshinte gjithashtu si bashkëpaneliste Komisioneren Tydd nga Australia, si dhe znj. Swati Mehta, përfaqësuese rajonale për Azinë dhe Paqësorin e OGP-së.

Pjesëmarrja në këtë simpoziium konfirmon angazhimin e Zyrës së Komisionerit për të qenë pjesë aktive e proceseve ndërkombëtare, por edhe për të promovuar punën e ICIC, detyrë kjo që i lind edhe nga Karta e Johannesburgut.



Na ndiqni edhe në rrjetet sociale:

